

URDHËR
Nr.504, datë 29.8.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b të ligjit nr. 9154, datë 16.1.2003 “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.
2. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 30.8.2019 deri në datën 6.9.2019.
3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, Drejtori i Inspektimit dhe Trajnimit do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.
5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet Drejtori i Inspektimit dhe Trajnimit, z. Endrit Musaj.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ARKIVAVE
Ardit Bido